



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



**Komuna e Prishtinës**  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12 dhe nenit 17, shkronja **b** e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 2, nënparagrafi 2.5 i Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, Udhëzimit administrativ MMPH, nr. 01/2018, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, nenit 15, paragrafi 15.1, shkronja **b**, nenit 33, paragrafi 33.2, shkronja **b** dhe nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2022, merr këtë

**V E N D I M**  
**PËR HARMONIZIM TË BLOKUT "D 2" NË KUADËR TË PLANIT RREGULLUES**  
**"ARBËRIA 3", TË MIRATUAR SIPAS VENDIMIT PËR PLOTËSIM DHE**  
**NDRYSHIM, 01. NR. 35-94056, DT.04.05.2015**

**Neni 1**

**Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor**

**MIRATOHET** Vendimi për fillimin e harmonizimit të bllokut "D 2" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", të miratuar sipas Vendimit për plotësim dhe ndryshim, 01. nr. 35-94056, dt. 04.05.2015.

**Neni 2**

**Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor**

Planet rregulluese të hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale, siç është përcaktuar në Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale komunale.

**Neni 3**

**Qëllimi i hartimit**

Me inicimin e harmonizimit të bllokut "D 2" në kuadër të planit rregullues "Arbëria 3" nga neni 1 i këtij vendimi, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimi i tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të zonës për të cilën hartohet plani.

## **Neni 4**

### **Kufiri i territorit**

Me këtë vendim do të ndryshohet destinimi i pjesërishëm i bllokut urban "D 2.1" dhe "D 2.2" të tërësisë "D", konkretisht destinimi i parcelës kadastrale nr. 10302-0, ZK Prishtinë, nga sport dhe rekreim dhe gjelbërim izolues në zonë mikse.

Zona mikse, është e planifikuar me destinim të përzier komercial dhe të banimit, administratë, biznes, zyrë, hoteleri, parkim dhe hapësira për sport dhe rekreacion.

Distancat e vendosjes së ndërtesave ndaj kufirit të parcelës nëse ka kthina, primare është min. 0.5H, nëse ka kthina sekondare 0.25H, në marrëveshje me fqinjën deri në kufi të parcelës.

## **Neni 5**

### **Kriteret e zhvillimit të zonës**

- ISHP – indeksi i shfrytëzimit të parcelës - maks. 35% ;
- ISGJ – indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit - min. 40%;
- ISHN – indeksi i shfrytëzimit të nëntokës - maks. 60%;
- ISPN – indeksi i sipërfaqes së përgjithshme të ndërtimit 2.4;
- Numri maksimal i kateve maks. P+7.

Kriteret e tjera të zhvillimit, si qasja, vija e rregullimit, vija e ndërtimit etj., do të jenë në tërësi sipas Planit rregullues "Arbëria 3".

## **Neni 6**

### **Subjekti përgjegjës për hartim**

Bartës i hartimit të harmonizimit të bllokut "D 2" në kuadër të planit rregullues "Arbëria 3", nga neni 1 i këtij vendimi, është Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Komunës së Prishtinës.

## **Neni 7**

### **Mjetet dhe mekanizmat e nevojshëm për hartimin e dokumentit**

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor janë të siguruar nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

## Neni 8

### Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi, është i obliguar që dokumentin e planifikimit hapësinor ta hartojë në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

## Neni 9

### Konsultimet publike

Projektpropozimi i harmonizimit të planit rregullues të hollësishëm para finalizimit, duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e harmonizimit të Propozimplanit rregullues të hollësishëm në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve, do të shpallen përmes njoftimeve publike.

## Neni 10

### Afati i vlefshmërisë

Plani rregullues i hollësishëm mbulon një periudhë së paku 8 (tetë) vjeçare.

## Neni 11

### Gjuha zyrtare

Harmonizimi i Planit rregullues të hollësishëm sipas nenit 1 të këtij vendimi, duhet të jetë në gjuhë zyrtare të Komunës dhe së paku në 3 (tri) kopje të shtypura e të vulosura dhe 3 (tri) kopje digjitale të originalit.

## Neni 12

### Programi

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë sipas nenit 11, pika 1.3 e Ligjit për planifikim hapësinor, nr. 04/L-174.

## Neni 13

### Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-350/05-257641/22, më 25.11.2022

KRYESUESI I KUVENDIT  
Fehmi Kupina



## **A R S Y E T I M**

**i**

**Vendimit për harmonizim të bllokut "D2" në kuadër të Planit Rregullues "Arbëria 3", të miratuar me vendimin për plotësimin dhe ndryshimin 01.nr. 35-94056, dt. 04.05.2015.**

### **Hyrje**

Kryeqyteti ka rivlerësuar kërkesën për rishqyrtimin e Planit Rregullues "Arbëria 3", në kuadër të bllokut D2-1 dhe D2.2 të tërësisë D, konkretisht destinimin e parcelës kadastrale nr.10302-0 Zona Kadastrale Prishtinë.

Kryeqyteti e sheh të nevojshme dhe të arsyeshme ndryshimin dhe plotësimin e pjesërishëm të bllokut urban të Planit Rregullues të Hollësishëm dhe ky plan do të inkorporohet në PZHK dhe Hartën Zonale.

### **Bashkangjitur:**

- skica e lokacionit të propozuar,
- ekstrakti nga plani zhvillimor komunal,
- skica e planit rregullues Arberia 3,



ekstrakti nga plani zhvillimor komunal





skica e planit rregullues Arberia 3

